



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë **05.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal, e caktuar me vendimin nr. 54, datë 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personit nën hetim **Murat Gjuniku**”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 238 dhe 248 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 149, datë 07.12.2024**, vendosi:

1. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale e caktuar me vendimin Nr. 54, datë 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personit nën hetim **Murat Gjuniku**, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve*”, e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; “*Falsifikimi i dokumentave*” e kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal; “*Grupi i strukturuar kriminal*”; “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale apo grupi kriminal*” të parashikuara nga nenet 298/2 - 28/4; 189/2 - 28/4; 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal.
2. Urdhërohet Policia Gjyqësore, që personi nën hetim Murat Gjuniku, të dërgohet menjëherë në institucionin e paraburgimit, për të qëndruar aty në dispozicion të organit procedues.
3. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe policia gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar brenda 5 ditëve, nga njoftimi i vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 07.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar